REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
KUKËS

Nr. Rregj. Them. (82400-00244-55-2020) 241
Data e rregj. 18/5/2020 **Data e vendimit: 28/7/202024**

VENDIM
"NË EMËR TË REPUBLIKËS"

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës e përbërë nga **gjyqtar Florin Demollari**, asistuar nga **sekretare gjyqësore Lazime Seferi**, sot më datë 28/7/2020, mori në shqyrtim në séance gjyqësore në praninë e palëve, çështjen penale me:

KËRKUES: **Nezir Dautaj**, i biri i Isuf dhe i Nepe, i datëlindjes 30/9/1962, mashkull, shtetas shqiptar, lindur dhe banues në Has, Kukës, mbrojtur nga **av. Gjergji Habilaj**, me Licensë Nr. 8696 dhe **av. Zenel Kastrati**, me Licensë Nr. 8696, zgjedhur prej tij me Prokurë të Posaçme Nr. 998 Rep., dhe Nr. 510 Kol., datë 25/3/2020.

PJESËMARRËS: Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës, përfaqësuar nga **prokurore Rita Gjati**.

OBJEKT: Revokimin e Vendimit Nr. (396) 220, datë 10/3/2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, me të cilin është vendosur sekuestrimi i pasurive si më poshtë vijon:

a) Njësi me sipërfaqe prej 100 m^2, në Zonën Kadastrale Nr. 8150, Volume Nr. 44, Faqe Nr. 239;
b) Truall me sipërfaqe 64 m^2, plus ndërtesë me sipërfaqe 64 m^2 në Zonën Kadastrale Nr. 8150, Volume Nr. 20, Faqe Nr. 61;
c) Automjet "Mercedes – Benz", tip ML 350 CDI, me targë AA434MN, në emër të Nezir Dautaj;
d) Automjet "BMË", tip X5, me targë AA999IS, në emër të Fation Nezir Dautaj;
e) Automjet "BMË", tip X5, me targë AA818LD, në emër të Fation Nezir Dautaj;

f) Automjet "Audi", tip R8, me targë AA546KU, në emër të Isuf Nezir Dautaj;
g) Bar – Kafe "Piano – Bar", në rrugën "Petro Nini Luarasi", në afërsi të "Shkollës së Baletit", Tiranë, në emër të Servete Dautaj, me NIPT: L62402043D.

BAZË LIGJORE: Neni 12 i Ligjit Nr. 10192, datë 3/12/2009 "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë".

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës (në vijim Gjykata) pasi dëgjoi kërkuesin Nezir Dautaj dhe përfaqësuesit e tij, të cilët përfundimisht kërkojnë revokimin e Vendimit Nr. (396) 22, datë 10/3/2020 të Gjykatës për sekuestrimin e pasurisë të përshkruar në objekt; pasi dëgjoi prokuroren e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës (në vijim Prokurori) që përfundimisht kërkon pranimin e kërkesës dhe revokimin e Vendimit Nr. (396) 22, datë 10/3/2020 të Gjykatës për shkak se ka përfunduar afati, dhe pas shqyrtimit në tërësi të kërkesës së bashku me aktet dhe provat e paraqitura nga palët,

VËREN:

- **Rrethanat e faktit**

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda (në vijim Prokuroria e Krimeve të Rënda), pas marrjes dijeni nga policia gjyqësore, ka filluar procedimin pasuror Nr. 113/2017, ndaj pasurive në zotërim të personit Fation Dautaj. Procedimi pasuror ka filluar për shkak të ngjarjes së ndodhur në lokalin "Piano Bar", në rrugën "Petro Nini Luarasi" në Tiranë, në vitin 2013; ku pas tentativës për shkatërrimin e kësaj prone me eksploziv, ngeli i plagosur personi Fation Dautaj.

Më datë 25/9/2015 Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës (në vijim Prokuroria e Kukësit), bazuar mbi dyshime të arsyeshme se ngjarja mund të ketë ndodhur për shkak të veprimtarisë kriminale të mëparshme të kryer prej personit Fation Dautaj në Angli, filloi ndjekjen penale ndaj tij për kryerjen e veprës penale "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale", parashikuar nga Nenin 287 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë (në vijim KP).

Më datë 16/12/2019 Prokuroria e Krimeve të Rënda vendosi shpalljen e moskompetencës dhe dërgimin e akteve të procedimit pasuror Nr. 113/2017 Prokurorisë së Kukësit, e cila më datë 6/1/2020, bazuar në Ligjin Nr. 10192, datë 3/12/2009 "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese

kundër pasurisë" (në vijim Ligji Antimafia), regjistroi procedimin pasuror Nr. 5, ndaj personit Fation Dautaj, të cilit i atribuohet vepra penale "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale", parashikuar nga Neni 287 i KP.

- **Procedura**

Në kuadër të këtij procedimi, më datë 4/3/2020 Prokurori ka paraqitur kërkesë për sekuestrimin e pasurive dhe veprimtarisë tregtare si më poshtë vijon:

a) Njësi me sipërfaqe prej 100 m^2, në Zonën Kadastrale Nr. 8150, Volume Nr. 44, Faqe Nr. 239;
b) Truall me sipërfaqe 64 m^2, plus ndërtesë me sipërfaqe 64 m^2 në Zonën Kadastrale Nr. 8150, Volume Nr. 20, Faqe Nr. 61;
c) Automjet "Mercedes – Benz", tip ML 350 CDI, me targë AA434MN, në emër të Nezir Dautaj;
d) Automjet "BMË", tip X5, me targë AA999IS, në emër të Fation Nezir Dautaj;
e) Automjet "BMË", tip X5, me targë AA818LD, në emër të Fation Nezir Dautaj;
f) Automjet "Audi", tip R8, me targë AA546KU, në emër të Isuf Nezir Dautaj;
g) Bar – Kafe "Piano – Bar", në rrugën "Petro Nini Luarasi", në afërsi të "Shkollës së Baletit", Tiranë, në emër të Servete Dautaj, me NIPT: L62402043D.

Gjykata me Vendimin Nr. (396) 220, datë 10/3/2020, ndër të tjera vendosi pranimin e kërkesës së Prokurorit dhe sekuestrimin e përkohshëm të pasurive të përshkruara mësipër.

Vendimi i mësipërm i Gjykatës është ekzekutuar nga Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (në vijim AAPSK) më datë 24/3/2020.

Me Shkresën Nr. 463 Prot., datë 2/4/2020 AAPSK ndër të tjera raporton se është sekuestruar në mënyrë vullnetare pasuria e llojit njësi me sipërfaqe prej 100 m^2, në Zonën Kadastrale Nr. 8150, Volume Nr. 44, Faqe Nr. 239 dhe truall me sipërfaqe 64 m^2, plus ndërtesë me sipërfaqe 64 m^2 në Zonën Kadastrale Nr. 8150, Volume Nr. 20, Faqe Nr. 61, të cilat janë të bashkuara në një të vetme, pikërisht në ambientin ku zhvillohet aktiviteti tregtar Bar-Kafe "Piano-Bar", regjistruar në ëmër të personit Servete Dautaj me NIPT: L62402043D. Gjithashtu është sekuestruar në mënyrë vullnetare edhe pasuria e llojit automjet "Mercedes – Benz", tip ML 350 CDI, me targë AA434MN, në emër të Nezir Dautaj. Ndërsa pasuritë automjet "BMË", tip X5, me targë AA999IS, në emër të Fation Nezir Dautaj, automjet "BMË", tip X5, me targë AA999IS, në emër të Fation Nezir Dautaj dhe automjet "Audi", tip R8, me targë AA546KU, në emër të Isuf Nezir Dautaj nuk u sekuestruan për shkak se dy të parat janë e njëjta pasuri e cila ka ndërruar pronësi më datë 18/11/2015 nga personi Fation Nezir Dautaj tek personi Beqir Imer Hoxha. Automjeti "Audi", tip R8, me targë AA546KU, në emër të Isuf Nezir Dautaj nuk

është sekuestruar për shkak se është çregjistruar në Republikën e Shqipërisë dhe është kthyer në vendin e origjinës.

Më datë 13/5/2020 Prokurori paraqitit kërkesë për konfiskimin e pasurisë të sekuestruar me Vendimin Nr. (396) 220, datë 10/3/2020 të Gjykatës.

Më datë 18/5/2020 kërkuesi Nezir Dautaj paraqiti kërkesë për revokimin e Vendimit Nr. (396) 220, datë 10/3/2020 të Gjykatës. Kërkuesi Nezir Dautaj është person i afërm (i paralindur, babai) i personit Fation Dautaj, pasuria e cila zotërohet prej tij është sekuestruar përkohësisht, për shkak të dyshimeve të arsyeshme të bazuara në indicie se mund të rrjedhi nga veprimtaria kriminale e kryer e kryer prej tij në Angli.

Gjykata pasi çmoi që çështjet kanë të njëjtin objekt dhe të njëjtat palë, me vendim të ndërmjetëm vendosi bashkimin dhe shqyrtimin e tyre në një proces gjyqësor.

- **E drejta e zbatueshme**

Neni 12/b i Ligjit Nr. 10192, datë 3/12/2009 "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë", "Revokimi i sekuestrimit":

> *"1. Gjykata, me kërkesë të palëve, vendos revokimin e sekuestrimit të pasurisë edhe përpara afatit të parashikuar nga pikat 2 dhe 3, të nenit 12, të këtij ligji.*
>
> *2. Gjykata vendos revokimin e sekuestrimit të pasurisë, duke e zëvendësuar atë me pasuri të barasvlershme, kur palët japin pëlqimin dhe gjykata e çmon të përshtatshme."*

- **Pretendimet e palëve**

1. Kërkuesi Nezir Dautaj dhe mbrojtësit e tij ligjor

Kërkuesi Nezir Dautaj pretendon ndër të tjera se Vendimi Nr. (396) 220, datë 10/3/2020 i Gjykatës duhet revokuar sepse e gjithë pasuria e përshkruar mësipër e sekuestruar përkohësisht është e justifikuar ligjërisht.

Kërkuesi Nezir Dautaj nuk dha pëlqimin dhe nuk paraqiti asnjë të dhënë për pasuri të barasvlershme për t'a zëvendësuar me pasurinë e sekuestruar.

2. Prokurori

Prokurori në seancë gjyqësore u shpreh se Vendimi Nr. (396) 220, datë 10/3/2020 i Gjykatës

me të cilin u vendos pranimi i kërkesës së Prokurorit dhe sekuestrimi i pasurisë së përshkruar në pjesën hyrëse të këtij vendimi, duhet të revokohet për shkak se afati ligjor prej 4 muajsh ka përfunduar.

- **Vlerësimi i Gjykatës**

Gjykata argumenton se vendimi për sekuestrimin e pasurisë mund të revokohet edhe përpara afatit 6 mujor të parashikuar në Nenin 12, paragrafi 2 i Ligjit Nr. 10192, datë 3/12/2009 "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë", vetëm në rast se personi, pasuria e të cilit është sekuestruar shpreh vullnetin dhe paraqet pasuri të tjera të barasvlershme për sekuestrim dhe palët japin pëlqimin për zëvendësimin e pasurisë.

Gjykata vlerëson se në çështjen në shqyrtim, kërkuesi Nezir Dautaj nuk shprehu vullnetin dhe paraqiti anjë pasuri tjetër të barasvlershme për sekuestrim dhe palët nuk dhanë pëlqimin për zëvendësimin e pasurisë së sekuestruar me pasuri të barasvlershme. Gjithashtu, Gjykata çmon se masa e sekuestrimit e caktuar me Vendimin Nr. (396) 220, datë 10/3/2020 është e vlefshme, pasi nga momenti i zbatimit të saj më datë 24/3/2020 deri sot më datë 28/7/2020 nuk ka përfunduar afati 6 mujor i vlefshmërisë së saj. Kështu edhe kërkesa e Prokurorit për revokimin e masës së sekuestrimit të pasurisë të përshkruar në pjesën hyrëse të këtij vendimi për shkak se ka përfunduar afati 4 mujor nuk është i bazuar në ligj sepse në Nenin 12, paragrafi 2 i Ligjit Nr. 10192, datë 3/12/2009 "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë", parashikohet ndër të tjera se afati i vlefshmërisë së masës së sekuestros është 6 muaj, duke filluar nga momenti i zbatimit.

- **Konkluzioni**

Përfundimisht, Gjykata çmon se kërkesa e personit Nezir Dautaj duhet rrëzuar për shkak se ai nuk shprehu vullnetin për të paraqitur pasuri të barasvlershme, për t'a zëvendësuar me pasurinë e sekuestruar. Gjithashtu, Gjykata konstaton se afati 6 mujor i vlefshmërisë së masës së sekuestros nuk ka përfunduar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata, bazuar në Nenin 12/b të Ligjit Nr. 10192, datë 3/12/2009 "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë",

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

- Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë.
- Kundër vendimit lejohet ankim në Gjykatën e Apelit Shkodër, brenda 15 ditëve, i cili fillon nga e nesërmja e njoftimit të këtij vendimi.

U shpall sot në Kukës më datë 28/7/2020!

Sekretare
Lazîme Seferi

Gjyqtar
Florin Demollari